



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 551/1
prot.

Shkodër, më 15.09.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 28, datë 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", neni 56 KPAD, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1, nënpika 1.6/, shkronja "b", neni 14, pika 5, 6, 7, neni 54, shkronja "d", neni 55, pika 3, VKM Nr. 405, datë 16.7.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", të shkresës së Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz nr. 2583 prot., datë 27.08.2025 "Procesverbal", shqyrtoi Vendimin Nr. 28, datë 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz "Për miratim marrëveshjeje për krijim të një personi juridik si SKP mes NJQV dhe KM për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, për zhvillimin e kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e performancës profesionale për t'u shërbyer komuniteteve dhe për t'i ndihmuar ato në përmbushjen e funksioneve të veta dhe kompetencave, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe për përmbushjen e sfidave, që lidhen me procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, në zbatim të VKM Nr. 405, datë 16.7.2025, me burim financimi të ardhurat e vetë bashkisë".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni duke patur në vëmendje edhe pikën 5 të VKM Nr. 405, datë 16.7.2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

